




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATE/A:	01.08.2016
REFERENC-Ë:	AKK-DPK 03-03/2120/16
PËR/ZA/TO:	z. Isak KEROLLI, Drejtor Ekzekutiv i Zyrës Ekzekutive të Prokurimit në Korporatën Energjetike të Kosovës
CC:	z. Arben GJUKAJ, Drejtor Menaxhues në Korporatën Energjetike të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI, <i>nek</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC B "



I nderuar z. KEROLLI,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 8 (par. 4), 9 (par. 1, nënpar. 1.6), 12 (par. 2) dhe 19 (par.1, nënpar. 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014 së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me Tenderin "Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC B" me numër prokurimi: KEKC-16-124-511, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e procesit rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC B" me numër prokurimi: KEKC-16-124-511, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës.

1/2

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. <u>03-03/DPK</u>	Nr. Prot <u>01-2468/16</u>
Dep. <u>03-03/DPK</u>	Br. Prot <u>01-2468/16</u>
Dep. <u>03-03/DPK</u>	Prot No <u>01-2468/16</u>
Nr. i faq. <u>02</u>	Data <u>01-08-2016</u>
Broj stranica <u>02</u>	Datum <u>01-08-2016</u>
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>01-08-2016</u>
PRISHTINE	

Arsyetime

Korporata Energjetike e Kosovës si Autoritet kontraktues me datë 20.06.2016, përmes Zyrës së Drejtorit Menaxhues në bashkëpunim me Zyrën Ekzekutive të Prokurimit ka paraqitur kërkesë zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes së cilës ka kërkuar që përfaqësuesi i AKK-së, të marr pjesë në monitorimin në lidhje me vlerësimin e tenderit me titull "Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC B" me numër prokurimi: KEKC-16-124-511.

Agjencia kundër Korrupsionit me datë 29.07.2016, ka nxjerrë vendim me numër protokollit *AKK-03-03/2120/16* për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull "*Riparimi i shiritave magjstral drejtimi TC B*" me numër prokurimi: *KEKC-16-124-511*, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës. Agjencia pasi ka trajtuar dokumentet në dispozicion dhe ka marr pjesë në monitorimin rreth ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të tenderëve ka konstatuar gjendjen faktike si në vijim:

Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit punë me vlerë të madhe të kontratës.

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 53 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 5 prej tyre.

Komisioni vlerësues, pasi ka bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave ka konstatuar se në këtë aktivitet të prokurimit kanë tenderuar 5 Operator ekonomik ku 2 prej tyre kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm në pajtim me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, andaj komisioni ka rekomanduar që Operatori i përgjegjshëm me çmimin më të ulët të shpallet fitues i tenderit dhe me të të lidhet kontrata.

Agjencia konstaton se gjatë procesit të vlerësimit nuk ka prova për shkelje procedurale-administrative, ndërsa sa i përket specifikacionit teknik, komisioni vlerësues ka qenë kompetent dhe tejet profesional, andaj kjo pjesë mbetet përgjegjësi e plotë e tyre.

Agjencia kundër Korrupsionit konsideron se pas ekzaminimit, krahasimit dhe vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit vlerësues dhe monitorimit të bërë nga Zyrtari përgjegjës i AKK-së nuk ka prova me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së, andaj kërkon nga Autoriteti kontraktues që të procedojë me këtë aktivitet të prokurimit konform Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !